



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Nr. 931/24  
Data. 04.04.24

**Prishtinë, 22.03.2024**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1883\_2024**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1.8 dhe Nenin 17 paragrafi 1.2, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 16 par. 1 nënpar. 1.19, Nenin 25 par. 1, Neni 28 par. 1 nënpar. 1.21 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-084),
- Nenin 2 par.2 nënpar. 2.3, Nenin 4 par. 1 nënpar. 1.2, dhe nenin 13 par. 2, Nenin 14, Nenin 17, Nenin 18 të Rregullës Nr. 04/2017 për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Nenin 11, Nenin 16, Nenin 18.2.2, Nenin 18.3.3., Neni 18.3.4. dhe Nenin 18.5.2 të Rregullave të Tregut;
- Ankesën/Kontestin e KOSTT SH.A. nr. 2513 dt. 06.12.2023 të iniciuar kundër KEK SH.A. lidhur me kontestimin dhe mos pagesën e faturës së muajit shkurt 2023 për jobalancet e shkaktuara nga KEK SH.A;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_2499\_02\_24** i dt.26.02.2024;

**në seancën e mbajtur më datë 22.03.2024 nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I. PUSHON procedura** e iniciuar nga ankuesi Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.A., kundër Korporatës Energjetike të Kosovës KEK Sh.A., lidhur me kontestimin dhe mos pagesën e faturës së muajit shkurt 2023, për jobalancet e shkaktuara nga KEK Sh.A., për shkak të shuarjes së objektit të kontestit.
- II.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- III.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**A r s y e t i m**

Zyra e Rregullatorit për Energji ( në tekstin e mëtejme: ZRRE) me datë 07.12.2023 ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut ( në tekstin e mëtejme: KOSTT SH.A.), kërkesën për iniciimin e kontestit kundër Korporatës Energjetike të Kosovës ( në tekstin e mëtejme: KEK SH.A.) lidhur me: “ Kontestimin dhe mos pagesën e faturës së muajit shkurt 2023 për jobalancet e shkaktuara nga KEK.SH.A”.



KOSTT Sh.A., në ankesën e tij adresuar ZRrE-së, e ka bashkëngjitur Profaturën e dt. 14.03.2023, me shifër PJBKEK\_02/2023 me përshkrim "Pagesa për energjinë e jobalancit për KEK" në vlerë prej 1,638,317.60 EUR, si dhe Faturën e dt. 15.03.2023, me shifër FJBKEK\_02/2023, nr. 079 me përshkrim "Pagesa për energjinë e jobalancit për KEK", në vlerë prej 1,638,317.60 EUR.

Me datë 14.09.2023, Korporata Energjetike e Kosovës KEK Sh.A., i adresohen KOSTT-it me një shkresë zyrtare, lidhur me faturën e dt. 15.03.2023, ku ndër të tjera theksojnë se: *"... shuma e obligimit të faturimit nuk i përket KEK-ut, për faktin se është identifikuar shkaktari i vërtetë i jobalancave në raportin e lartpërmendur. Duke marrë parasysh faktin se, faturimi është bërë para përfundimit të raportit të përbashkët të KOSTT dhe KEK me nr. protokollit 566 dhe 349 të dt. 17.03.2023, konsiderojmë se me konkluzionet e raportit në fjalë ka rënë baza juridike për një faturim të tillë. Prandaj, me këtë rast, KEK-u kthen prapa faturën në fjalë dhe kërkon që KOSTT të bëjë rishikimin e saj, me kusht që e njëjta të paraqet obligimin e saktë për kostot e shkaktuara vetëm nga dështimi i KEK-ut në përmbushjen e obligimeve të kontraktuara (nominimet). Më tej, KEK-u kishte kërkuar që të bëhej korrigjimi i faturës në afatin 7 ditor, në mënyrë që të përmbushet obligimi i saktë ndaj sistemit.*

Me datë 03.11.2023, KOSTT-i ka pranuar nga KEK-u pagesën e pjeshme të faturës me nr. 079 në vlerë prej 1,376,795.12 EUR, duke mbetur e papaguar pjesa prej 261,522.48 EUR, në emër të jobalancave të konstestuara nga ana e KEK-ut. KOSTT SH.A., me datë 07.12.2023 ka parashtruar ankese ne ZRRE duke theksuar se në përputhje me Nenin 17 par. 1 nënpar. 1.2 të Ligjit për Rregullatorin për Energji dhe Nenin 13 parag 2 të Rregullës Nr. 04/2017 për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë duke kërkuar nga ZRRE zgjidhjen e kontestit në afat sa më të shkurtër kohor, respektivisht të detyroj KEK SH.A., që të bëjë pagesën e pjesës së mbetur të faturës 079 për jo balancat e shkaktuara ne muajin shkurt 2023.

Me datë 11.12.2023, ZRrE, me email zyrtar i është adresuar KEK-ut, me kërkesën që të përfundohen të gjitha pagesat e mbetura për faturën e jobalancave për muajin shkurt 2023, duke iu referuar kështu, tashmë rastit të njëjtë të cilin ZRrE e kishte zgjidhur përmes vendimit V\_1761\_2023, të dt. 21.09.2023, me të cilin vendim ZRrE e kishte obliguar KEK-un që t'i bëjë pagesat për jo balancë, në çështjet e njëjtë të ngritur nga KOSTT-i.

Me datë 16.02.2024, ZRrE ka pranuar Njoftimin (email zyrtar) nga KEK-u, me të cilin konfirmohet pagesa e pjesës së mbetur të faturës, në vlerë prej 299,212.60 EUR, me subjekt energjia e jobalancit dhe 261,522.48 EUR, me subjekt "energjia e jobalancit – diferenca", sipas kërkesës së ZRrE-së.

Me datë 20.02.2024 ZRrE i është adresuar KOSTT-it, me kërkesën që të konfirmohet pranimi i pagesave të KEK-ut ndaj KOSTT-it, dhe në rast se nuk ka kundërshtime të tjera lidhur me ankesën për faturën e jobalancave për periudhën shkurt 2023, atëherë të njoftohet ZRrE, në mënyrë që të mbyllet kontesti i regjistruar.

Me datë 21.02.2024, ZRrE e ka pranuar një shkresë/kërkesë nga KOSTT për trajtim të kontestit të datës 7 dhjetor 2023, ndaj KEK Sh.A., me anë të së cilës, e konfirmojnë pagesën e faturave (kryegjësë) nga ana e KEK Sh.A., mirëpo, kanë kërkuar trajtim të mëtejshëm të kontestit në fjalë, në aspektin e së drejtës ligjore dhe rregullative. Po ashtu, nga KOSTT janë shprehur se: *"KOSTT rezervon të drejtën për kërkesën e pjesës së interesit nga KEK Sh.A., për pagesat e vonuara të faturave të dy kontesteve në fjalë"*.



Sic edhe mund të shihet nga shkresat e lëndës dhe kronologjia e paraqitur si më lartë, pasi që KOSTT-i e kishte iniciuar rastin në Zyrën e Rregullatorit për Energji, ZRrE, respektivisht ZRrE, duke u bazuar tashmë në praktikën administrative të krijuar, duke iu referuar vendimit të Bordit të datës 21.09.2023, me nr. V\_1761\_2023, vendim ky me të cilin ishte trajtuar çështja saktësisht e njëjtë, e kishte obliguar KEK-un që t'i përfundoj të gjitha pagesat e mbetura për faturën e jobalancave për muajin shkurt 2023. Pas pranimit të emailit/kërkesës së ZRrE-së, nga KEK-u, është konfirmuar përfundimi i pagesave sipas kërkesës së ZRrE-së. Më tej ZRrE, ka kërkuar nga KOSTT-i që ta konfirmojnë pranimin e pagesave dhe ta njoftojnë ZRrE-në për ndonjë kundërshtim eventual. Përfundimisht, nga KOSTT është konfirmuar pagesa e faturave nga ana e KEK-ut, më kërkesën që të trajtohet rasti në aspektin ligjor.

Bordi i ZRrE pasi që ka analizuar me kujdes këtë çështje, vlerëson që, pasi që objekti i kontestit është i shuar, nuk ekziston më, pasi që palët në kontest i kanë përfunduar obligimet ndaj njëra – tjetrës, atëherë procedura e kontestit të ngritur duhet të pushohet.

Ndërkaq, lidhur me çështjen e ngritur nga KOSTT-i për pagesën e interesit nga ana e KEK-ut, për pagesat e vonuara të faturave, Bordi i ZRrE thekson se, kjo kërkesë nuk ka qenë e ngritur në kontestin e parë, me të cilin ZRrE e kishte trajtuar lëndën në mënyrë meritore dhe e kishte obliguar KEK-un që t'i përfundoj obligimet e tij ligjore. Po ashtu, vlen të theksohet se, një kërkesë e tillë nuk është ngritur as në kontestin e dytë, të natyrës së njëjtë, në ankesën e KOSTT-it të dt. 07.12.2023. Si pasojë, ZRrE nuk do të lëshohet në shqyrtimin dhe trajtimin e saj, duke e vlerësuar këtë kërkesë si tërësisht të pathemeltë. Një zgjidhje e tillë ligjore parashihet edhe në nenin 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si në vijim: "Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse".


Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji pas shqyrtimit, analizimit, administrimit të provave dhe të dëshmitë të paraqitura nga palët në kontest si dhe Rregullave të Tregut ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.




**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Pejzullahu, Kryesues

  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
Gani Buçaj, anëtar

  
Arta Isufi, Anëtare

  
Adnan Prehiqi, Anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KOSTT,
- KEK dhe
- Arkivit të ZRRE-së.